



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:259995
Datë: 18.06.2024
Numri i dokumentit: 05828313

C.nr.2576/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Erlinda Elezi-Tosku, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.A. nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson I.R., avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shujtës ditore, inflacionit dhe kualifikimit, vlera e kontestit 3,197.00 euro, jashtë seancës, me datë 13.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.A. nga Gjilani dhe detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit për shpenzimet e ushqimit për periudhën kohore 27.09.2021 – 21.11.2022, për 178 ditë pune, duke llogaritur nga 2 euro në ditë, t'ia paguaj shumën prej 356.00 euro; në emër të kompensimit të diferencës së pagës mbi bazën e kualifikimit master për periudhën kohore 21.02.2021 – 06.02.2023, për 23 muaj, duke llogaritur nga 78.1 euro në muaj, t'ia paguaj shumën prej 1,796.30 euro; dhe në emër të pagesës shtesë të përqindjes së inflacionit për periudhën 01.01.2021 – 21.11.2022, t'ia paguaj shumën prej 756.98 euro; apo shumën e përgjithshme prej 2,909.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 27.11.2023 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. Refuzohet e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit sa i përket kompensimit për shpenzime të ushqimit të llogaritura për periudhën nga data 14.09.2020, në shumën prej 288.00 euro.

III. Detyrohet e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ia paguaj paditësit shumën prej 135.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 27.11.2023 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin e shujtës ditore, inflacionit dhe kualifikimit, në vlerë të kontestit prej 3,197.00 euro.

Në padi ka theksuar i njëjti është e punësuar në Shkollën e Mesme të Muzikës në Gjilan, në cilësinë e mësimdhënësit dhe vazhdon të jetë në këtë pozitë të punës. Ka shtuar se asnjëherë nuk është kompensuar nga e paditura për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, për diferencën në pagë për shkak të kualifikimit/licencimit master dhe sipas përqindjes së inflacionit, përkundër që kjo e drejtë i takon sipas vendimit të qeverisë dhe kontratave kolektive, edhe atë për periudhën kohore 14.09.2020 – 21.11.2022 për ushqim; 21.02.2021 – 06.02.2023 për kualifikim dhe 01.01.2021 – 21.11.2022 për inflacion. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumës prej 644.00 euro për shpenzime të ushqimi; 1,796.30 euro për kompensimin e kualifikimit; dhe 756.98 euro për kompensimin e inflacionit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro për përpilim të padisë dhe për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 04.12.2023 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi i shpenzimeve të ushqimit, kualifikimit dhe inflacionit, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” dhe 399.1 që përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin merititor me të cilën refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie punë te e paditura (fakt i vërtetuar nga kontrata e punës në kohë të pacaktuar e lidhur mes paditësit dhe të paditurës, nr.prot.186 e dt.01.09.2017).

Për periudhën kohore 14.09.2020 – 21.11.2022 ka gjithsej 337 ditë pune, ndërsa për periudhën 27.09.2021 – 21.11.2022 ka 178 ditë pune (fakt i vërtetuar nga vërtetimi nr.prot.190/2021 i dt.21.11.2022 i lëshuar nga Shkollën e Muzikës në Gjilan).

I njëjti është i kualifikuar me master (vendim, Ref.nr.6-2365 i dt.23.05.2017 i lëshuar nga MASHT-i), ndërsa pagën bazë e ka në lartësi prej 459.00 euro, e për kualifikim paguhet në shumën prej 82.55 euro (lista e pagës e lëshuar në emër të paditësit nga BRK).

Përqindja e shkallës së inflacionit sipas entit të statistikave për vitin 2021 është 3.4 %, ndërsa për vitin 2022 është 11.6 % (fakt i provuar nga të dhënat e lëshuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I dhe jo themelësia e refuzuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008 dhe në Kontratat Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendës drejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, në nenin 3, paragrafi 2 është përcaktuar se “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”; nenin 35, paragrafi 7 se “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2€ (dy euro) për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës

primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit të kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”; dhe neni 35, paragrafi 10 se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”.

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017 – 21.01.2021 dhe për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr.214/2023 të datës 05.10.2023.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë paditësit, pasi ka gjetur se në rastin konkret paditësi ka kërkuar shpenzimet e ushqimit për periudhën 14.09.2020 – 21.11.2022, ndërsa e paditura është thirrë në parashkrim të kërkesës dhe bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, kërkesa e paditësit është pjesërisht e parashkruar.

Në nenin 87 të LP-së, është përcaktuar se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, prandaj gjykata duke marrë parasysh faktin se kërkesa e paditësit është kërkesë monetare nga marrëdhënia e punës dhe e paditura është thirrë në parashkrim të kërkesës, gjeti se për 3 vite mbrapa nga data e inicimit të padisë në këtë gjykatë (27.11.2023), pjesa tjetër e kërkesës së paditësit deri më datë 27.11.2020 është e parashkruar.

Në rastin konkret, gjykata ka parasysh se i ka refuzuar më tepër paditësit sesa pjesa e parashkruar, pasi pjesa e parashkruar është 14.09.2020 – 27.11.2020, ndërsa gjykata i ka refuzuar pjesën 14.09.2020 – 27.09.2021, mirëpo në mungesë të provave për të vërtetuar saktë se sa kanë qenë ditët e pranisë në punë të paditësit për këtë periudhë, gjykata i refuzoi edhe këtë pjesë.

Nga kjo arsye, gjykata i njohi shpenzimet e ushqimit vetëm për 178 ditë pune, aq sa paditësi ka pasur ditë pune të e paditura për këtë periudhë, ndërsa lartësinë ia vërtetoi duke llogaritur nga 2 euro në ditë, të përcaktuar si në nenin 35.7 të KKAK-së.

Pjesën e kërkuar nga data 14.09.2020, gjykata ia refuzoi të pabazuar, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Kompensimin e kërkuar për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me master, gjykata ia njohi të bazuar paditësit. Në këtë rast, gjykata ka konstatuar se paditësi është i kualifikuar me master dhe sipas përqindjes së përcaktuar me vendimin e qeverisë është dashur të paguhet në shumën prej 160.65 euro në muaj, mirëpo është paguar në shumën prej 82.55 euro në muaj, prandaj pjesën e mbetur borxh prej 78.1 euro në muaj, gjykata e detyroi të paditurën t’ia kompensojë për periudhën kohore 21.02.2021 – 06.02.2023, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Edhe kërkesën për kompensimin e inflacionit, gjykata ia njohi të bazuar paditësit dhe e detyroi të paditurën që t'ia kompensojë inflacionin paditësit për periudhën 01.01.2021 – 21.11.2022, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Kërkesa e kompensimi të kualifikimit dhe inflacionit, në rastin konkret nuk është e përfshirë në parashkrim, meqë padia është iniciuar më datë 27.11.2023, ndërsa kërkesa e paditësit është nga data 01.01.2021, përkatësisht 21.01.2021.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se Vendimi i Qeverisë është zbatuar sipas detyrës zyrtare, gjykata vlerëson se nuk qëndron ky pretendim pasi vendimi nuk është zbatuar në tërësi nga ana e të paditurës si punëdhënëse, përkatësisht të punësuarit janë paguar pjesërisht sipas kualifikimit të tyre, e jo mbi bazën e përqindjes siç e rregullon ky vendim. Edhe për pretendimin e të paditurës se inflacioni nuk mund të kërkohej vetëm në një sektor të punës, gjykata vlerëson se me kontratë kolektive është përcaktuar se inflacioni ka ndikim në pagën e mësimdhënësve, prandaj edhe këtë pretendim e gjeti të pabazuar.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, ashtu që pjesën e kërkuar më tepër sesa i takon sipas numrit tarifor, gjykata nuk ia njohi paditësit.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.2576/2023, më datë 13.06.2024

Gjyqtarja,
Erlinda Elezi-Tosku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.